

## **DEPARTAMENTI I TEKSTILIT SI PJESË PËRBERËSE E FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE**

**Prof. Jorgaq KAÇANI**

Të dashur miq dhe të ftuar,

Që nga krijimi i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike janë të shumta evenimentet që kanë përcjellë historinë e tij. Natyrisht një nga këto evenimente është krijimi i Katedrës së Tekstilit sot Departamenti i Tekstilit.

Është një rast i mirë, 20 – vjetori i Departamentit të Tekstilit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, për të kujtuar sot punën dhe përpjekjet për krijimin e degës së inxhinierisë tekstile si degë e veçantë në universitetin tonë.

Dega e inxhinierisë së tekstilit, ka filluar si e para degë në funksion të industrisë tekstile në qytetin e Beratit më 1968, si filial i Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Mësimdhënësit e parë në këtë filial vinin nga katedrat e Fakultetit të Inxhinierisë dhe nga specialistë, inxhinierë tekstili të kualifikuar në Universitetin Politeknik të Lodz Poloni etj.

Në vitin 1980 filluan përpjekjet për ngritjen e degës së inxhinierisë tekstile, si edhe degët e tjera inxhinierike me një kurs të plotë universitar brenda Fakultetit të Inxhinierisë në Tiranë. Në vitin akademik 1981-1982 filloi dhe kursi i parë i inxhinierëve tekstil në Fakultetin e Inxhinierisë në Tiranë me 31 studentë.

Në vitin 1984, ekzistenca e një dege të re të veçantë brenda Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, me një fizionomi krejt të ndryshme nga degët e tjera si inxhinieria mekanike, elektrike, elektronike dhe metalurgjike sollën si domosdoshmëri krijimin e katedrës së tekstilit me shef katedre ing. Kozma Xhero.

Historia e kësaj katedre është e lidhur ngushtë me punën kolosale të ekipit mësimdhënës në drejtim të planeve dhe programeve mësimore, hartimin e teksteve universitare, artikujve shkencorë në fushën e inxhinierisë tekstile etj.

Krijimi i planeve dhe programeve mësimore të përshtatshme për nevojat e atëhershme të industrisë tekstile lidhet me emra të spikatur të këtij Departamenti si Prof. Dr. Taxhedin Baholli, ing. Eva Budina, Ing. Kozma Xhero, ing. Shega Shaplo etj.

Duhet vlerësuar këtu kontributi i veçantë i Prof. Taxhedin Bahollit në themelimin e degës së inxhinierisë tekstile së pari në Berat dhe pastaj në Tiranë, në hartimin e teksteve universitare si “Strukturë Filli”, “Teknologji Speciale e Filaturës”, “Fizika e Tekstileve”, në artikujt e shumtë shkencorë të fushës së inxhinierisë tekstile, në udheheqjen e diplomave dhe doktoraturave.

Për këtë, ka qënë në nderin e Fakultetit tonë të ishte institucioni shkencor ku u bë mbrojtja e doktoraturës së Taxhedin Bahollit më 1989 dhe më pas në nderin e këshillit

të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të votonte atë për titullin Profesor në vitin 2002.

Unë do të doja të kujtoja gjithashtu ing. Eva Budina, shefe e katedrës së tekstilit në vitet 1987-1991, autore e teksteve mësimore “Teknologji e Përgjithëshme e Tekstilit” dhe “Organizimi i ndërmarjeve tekstile”, Dr. Albana Petrela shefe e katedrës dhe pastaj përgjegjëse e Departamentit të Tekstilit në vitet 1991 – 2001, autore e disa artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit.

Vitet '90 e përfshinë Departamentin e Tekstilit si edhe të gjithë Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në ristrukturimin e tij për t'iu përgjigjur më mirë kushteve të reja sociale dhe ekonomike dhe tregut të punës në Shqipëri; si dhe në tejkalimin e vështirësive të krijuara nga largimi i disa prej anëtarëve më të kualifikuar të stafit pedagogjik.

Në vitin 1994 u ndryshua dhe emërtimi nga Katedër Tekstili në Departament i Tekstilit.

Ristrukturimi i programeve dhe planeve mësimore konform modeleve të universiteteve perëndimore në Departamentin e Tekstilit bënë që në këtë Departament të kishim lëndë të reja si “Modelim veshjesh”, “Reologji”, “Strukturë e tesktilëve të sheshta”, “Marketim Tekstili etj., përmirësim të mbështetjes me literaturë bashkëkohore të lëndëve teknologjike dhe teorike.

Kualifikimet e disa anëtarëve të stafit pedagogjik të Departamentit të Tekstileve në universtitet politeknike të Torinos (Itali), Aachen (Gjermani), Muolhouse (France), Milano (Itali), Ghent (Belgjikë) në kuadrin e projekteve Tempus ishin një ndihmë e madhe në procesin e ristrukturimit të curriculës së inxhinierit tekstil dhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të organizimit të degës së inxhinierisë tekstile në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

Sot, studentët që ndjekin studimet pranë Departamentit të Tekstilit, marrin njohuritë e para tekstile në semestrin e pestë dhe i vazhdojnë ato deri në semestrin e IX duke vazhduar më pas me projekt diplomën dhe laurimin përfundimtar si “Inxhinierë Tekstili”. Njohuritë e mara nga studentët e degës së inxhinierisë tekstile synojnë harmonizimin e teorisë me praktikën e cila kryhet pranë ndërmarjeve prodhuese dhe laboratorët e këtij Departamenti.

Dhënia e informacionit është konceptuar e tillë që studenti të marrë dije të thella në fushat e teknologjisë së filaturimit, tezgjahimit, trikotimit, teknologjisë së prodhimit të veshjeve, të modelimit dhe konstruktimit inxhinierik të veshjeve, të përmbarimit të tekstileve etj.

Duhet të theksoj që kurrikula tekstile është kontribut edhe i Departamenteve të tjerë si ai i Mekanikës, Manaxhimit të Prodhimit, Energjitikës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të Matematikës, Fizikës, Kimisë etj në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Një ndër Laboratorët e këtij Departamenti, ai Fiziko – Mekanik dhe Kimik i Tekstilit është laborator i parë dhe i vetmi i akredituar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Standartizimit, sipas standarteve

ndërkombëtare i Universitetit Politeknik të Tiranës që nga viti 1996 për kryerjen e analizave të plota laboratorike dhe kontrollin cilësor të produkteve, gjysëm produkteve dhe lëndëve të para tekstile.

Jo vetëm laboratorit i akredituar i tekstit por edhe përfshirja e stafit pedagogjik të këtij Departamenti në projekte kombëtare dhe lokale përbëjnë një lidhje të fortë që Departamenti i Tekstit po krijon me prodhimin industrial në Shqipëri.

Duke vlerësuar përpjekjet e stafit aktual të Departamentit të Tekstit ing. Genti Guxho, ing. Enno Bozdo, ing. Artan Samara, ing. Ermira Shehi, ing. Blerina Kolgjini dhe Ilda Kazani në drejtim të kualifikimit të tyre shkencor, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në degën e inxhinierisë tekstile, të pedagogëve të jashtëm si Lefter Samara, Arben Fagu, Isa Feçi, Vojsava Karagjozi, Fatmir Demneri dhe Arlinda Shalësi i uroj ata dhe gjithë pjesëmarrësit e kësaj Konference për 20 – vjetorin e Departamentit të Tekstit dhe për punime të mbara.

Faleminderit.

**Ing. Genti  
GUXHO**

**Të nderuar Zonja dhe Zotërinj!**

**I nderuar z. Rektor i UPT!**

**I nderuar z. Dekan i FIM!**

Kjo Konferencë e Parë e Tekstit mbledhet për të përkujtuar 20 – vjetorin e krijimit të Departamentit të Tekstit pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Në këto 20 vjet ka ndryshuar shumë gjëra, që kanë të bëjnë me industrinë tekstile në Shqipëri dhe me rolin e universitetit në shoqëri. Sigurisht, këto ndryshime kanë sjellë sfida të reja përpara Universitetit në përgjithësi, dhe degës dhe Departamentit të Inxhinierisë Tekstile.

Dikur dega e inxhinierisë tekstile të cilën e mbulon Departamenti i Tekstit, hidhte në tregun e punës inxhinierë që i shërbenin industrisë masive të ekonomisë së centralizuar.

Sot edhe pse industria tekstile, në veçanti ajo konfeksionuese, përfaqëson një ndër dy industritë më të mëdha në kontributin e prodhimit të brendshëm bruto dhe industrinë e parë për sa i përket eksporteve industriale shqiptare (me rreth 60% të tyre), përfaqëson ndaj tregut të punës ka ndryshuar shumë dhe për këtë arsye stafi pedagogjik i Departamentit të Tekstit ka hyrë në vitet '90 në një proces të gjatë riorganizimi.

Jemi të ndërgjegjshëm që ky proces do të zgjasë shumë. Treguesit e ekonomisë shqiptare dhe numri i aplikanteve për studime në degën e inxhinierisë tekstile janë të tilla që të mund të gjykojmë me optimizëm mbi të ardhmen e kësaj industrie. Pikërisht këtë gjë ne do të kemi gjithmonë parasysh në mënyrë që të jemi sa më të sukseshëm duke i ofruar tregut të punës atë që vërtet i duhet industrisë aktuale.

Në vitet '90 curricula tekstile pësoi një reformim themelor për të bërë të mundur:

përafrimin e saj me curriculat e universitetve perëndimore;  
vendosjen e balancave të reja midis formimit në auditor dhe atij praktik;  
tendencën për t'i dhënë përparësi formimit të studentit të inxhinierisë tekstile në teknologjitë përfundimtare të tekstilit;

Pavarësisht vështirësive që u hasën në këtë proces, si:

mbingarkesa mësimore e studentëve  
cilësia e mësimdhënies që kishte nevojë për përmirësim  
varfëria e universiteteve shqiptare për të kryer investime në aparatura laboratorike,  
sot më shumë se më parë kemi një degë e cila plotëson formimin e inxhinierin tekstil në fushat teknologjike, të manaxhimit industrial të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme tekstile, të konstruktimit, modelimit dhe stilizimit të veshjeve etj.

Natyrisht, e gjithë kjo punë në ngritjen e një curricule të vërtetë perëndimore për inxhinierinë tekstile është bazuar në curriculat e projektuara që në vitet '80 nga profesorët të cilët i kujtojmë me nderim të thellë si Prof. Baholli, Kozma Xhero, Eva Budina, Shega Shaplo dhe Dr. Albana Petrela, pa të cilët kjo pasuri, një nga tre të tilla në të gjithë gadishullin ballkanik, nuk do të ekzistonte.

Kështu Departamenti i Tekstilit është sot në gjendje t'i përgjigjet me përvojën dhe stafin e vet një sfide të re asaj të implementimit të Kartës së Bolonjës.

Një nga synimet e Departamentit të Tekstilit ka qënë lidhja e ngushtë me prodhimin industrial vendas përvojë e trashëguar nga bashkëpunimi tepër i ngushtë i Katedrës së Tekstilit me Institutin e Studimeve dhe Projektmeve të Industrisë së Lehtë. Konceptet e bashkëpunimit me prodhimin e industrial kanë ndryshuar; për këtë Departamenti i Tekstilit ka gjetur mekanizma efikas për të operuar si një i vetëm në ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve. Këtu duhet përmendur:

Bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë në fushën e studimit të gjendjes aktuale të industrisë tekstile në Shqipëri

Bashkëpunimi me USAID në fushën e vlerësimit të nevojave të konsumatorit në Shqipëri

Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithëshme të Standartizimit për implementimn e standarteve ndërkombëtare në fushën tekstile, nëpërmjet pjesmarjes në Komitetet Teknike S SH

Dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme akreditimi i Laboratorit Fiziko – Mekanik dhe Kimik të Tekstilit sipas standarteve ndërkombëtare për kontrollin e cilësisë së produkteve dhe lëndëve të para tekstile të prodhuara në vend apo të importuara. Ky Laborator funksionoi si i tillë që nga viti 1996 dhe në vitin 2003 mori çertifikatën nr. 1 ndër Laboratorët e ndryshëm të akredituara në Shqipëri. Të ardhurat e krijuara prej tij

gjithashtu i shërbejnë përmirësimit të aparaturës laboratorike në Departamentin e Tekstilit

Sigurisht këto janë vetëm disa hapa për të krijuar një njësi të vërtetë jo vetëm mësimore por edhe shkencore të inxhinierisë tekstile në UPT.

**Te nderuar zonja dhe zoterinj!**

Keto ishin ne menyre te permbledhur arrijtet dhe sfidat e ketij Departamenti qe eshte krijuar vetem 20 vjet me pare.

Po e mbyll fjalen time duke theksuar edhe nje here angazhimin e stafit te ri te Departamentit per ta kthyer ate ne nje njesi moderne dhe efikase shkencore dhe mesimore universitare.

Dua te falenderoj Dekanatin e FIM dhe Rektoratin e UPT per mbeshtetjen e tyre ne permbushje te angazhimit tone.

Ju falemnderit edhe nje here per pranine tuaj ketu, duke shpresuar se do te jeni prezent edhe ne Konferenca e Simpoziume te tjera qe Departamenti i Tekstilit do te organizoje.